VENDIM
Nr.324, datë 24.7.1992

PËR NDRYSHIMIN E ÇMIMEVE TË DISA ARTIKUJVE E TARIFAVE QË NUK LIBERALIZOHEN

Në mbështetje të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 "Për çmimet dhe tarifat", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Minmistrave

VENDOSI:

1. Çmimet e disa artikujve dhe tarifave që nuk liberalizohen, caktohen sipas pasqyrës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Këto çmime janë të detyrueshme për zbatim edhe nga persnat juridikë a fizikë privatë, vendas a të huaj.

2. Për grup-artikujt e tarifat, çmimet e të cilëve shumëfishohen, si barnat, qiratë e banesave si dhe ngrohjen e përqendruar të banesave, ministritë përkatëse në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, u njoftojnë subjekteve të interesuara çmimet e reja, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Për grup-artikujt dru zjarri, barna,vajguri , ngrohjen e përqendruar të banesave, si dhe për tarifat e transoportit të udhëtarëve, diferencat ndërmjet shpenzimeve dhe çmimeve e tarifave të miratuara në këtë vendim, subvencionohen nga buxheti i shtetit, për sasitë që shkojnë vetëm për popullsinë.

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në bashkëpunim me minsitritë e interesuara, i propozojnë Këshillit të Ministrave masën e subvencioneve përkatëse.

4. Për artikujt dhe tarifat, çmimet e të cilave nuk liberalizohen, mimistritë e interesuara, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, përcaktojnë çmimet e shumëfisheve dhe nënfisheve të këtyre artikujve, pa prekur nivelin bazë të çmimeve të tyre që miratohen nga Këshilli i Ministrave.

5. Për artikujt e tarifat, çmimet e të cilëve ndryshohen sipas pasqyrës së këtij vendimi, diferencat ndërmjet çmimeve të reja dhe atyre të mëparshme derdhen detyrimisht në buxhetin e shtetit, për sasitë që do të jenë gjendje pranë ndërmarjreve shtetërore përkatëse dhe njësive të tregtisë nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi. Organet përkatëse të pushtetit lokal të kontrollojnë kryerjen e inventarizimeve, sistemimin e diferencave dhe derdhjen e tyre në buxhet.

6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit që, në bashkëpunime Ministrinë e Financave e të Ekonomisë të përcaktojë zonat që do të përfitojnë kompensim, si dhe masën e kompensimit për fshatin, si rezultat i rritjes së çmimit të bukës masive e të miellit për këtë lloj buke.

Çmimi i shitjes së grurit për bukën masive të fshatit caktohet 9,5 lekë kilogrami.

7. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe misitritë e tjera të interesuara nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

8. Pika 3 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.374, datë 11.10.1991 "Për privatizmin e veprimtarisë së prodhimit e të shitjes së bukës në fshat", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 gusht 1992

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

ÇMIMET E ARTIKUJVE DHE TARIFAT E KOMPETENCËS SË KËSHILIT TË MINISTRAVE

(për popullsinë)

1. Artikuj ushqimorë
a) Bukë masive:

- Me miell gruri rreze 96%.....9.6 lekë/kg
- Me miell gruri rreze 90%.....10.6 lekë/kg
- Me miell gruri rreze 85%.....12 lekë/kg
- Me miell gruri rreze 80%.....13 lekë/kg
- Me miell gruri rreze 75%.....17.8 lekë/kg

b) Miell gruri për bukë masive:
- Rreze 96%.....10.4 lekë/kg
- Rreze 90%.....10.9 lekë/kg
- Rreze 85%.....11.7 lekë/kg
- Rreze 80%.....12.4 lekë/kg
- Rreze 75%.....13 lekë/kg

2. Vaj vegjetal:
- I rafinuar i hapur…….51 lekë/ litri
- I rafinuar i ambalazhuar (pa vleftën e ambalazhit)…….55 lekë/ litri
- I parafinuar i hapur……45 lekë/ litri
- I parafinuar i ambalazhuar (pa vleftën e ambalazhit)……48 lekë/ litri
- I parafinuar për përpunim……39.6 lekë/ litri

3. Sheqer……..28 lekë/ kg
4. Oriz……..28 lekë/ kg
5. Ujë i pijshëm…….4 lekë/ m3
6. Kripë gjelle:
- e jodizuar……12 lekë/ kg
- e bardhë……5 lekë/ kg
- e zakonshme (e papërpunuar)….3.5 lekë/ kg

II. Artikuj joushqimorë e tarifa
1. Dru zjarri……..220 lekë/mst
2. Energji elektrike…….Nuk ndryshon
3. BarnatRriten mesatarisht ……2.5 herë ndaj atyre ekzistuese
4. Qiratë e banesaveRriten ……..2 herë ndaj atyre ekzistuese
5. Librat shkollorë për
arsimin 8-vjeçar e të mesëm
dhe fletoret nuk ndryshojnë
6. Vajguri…….4 lekë/litri
7. Ngrohja e përqendruar e banesave……Rritet 3 herë ndaj atyre ekzistuese
8. Tarifat e transportit të udhëtarëve……...Sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave
9. Tarifat e PTT-së……Nuk ndryshojnë
10. Sapun rrobash…….85 lekë/kg